

STATUTI

I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

B-JASHARI 2021 SH.P.K.

Ne Lezhe sot me daten 17.02.2021 ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", "Statuti" te Ligjit nr.7580 date 29.07.1994 "Kodi Civili Rrepublikes se Shqiperise".ligji nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit"

1.Z.Bashkim Jashari, atesia Musa, amesia Nexhmije i datelindjes 03.03.1968 lindur dhe banuese ne Vushtrri, Kosove madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar i identifikuar nepermjet leternjoftimit kosovare me nr.1001787256.

Me vullnetin e lire dhe te plote me cilesine e ortakeve vendosen:

Themelimin e Shoqerise me Pergjegjiesi te Kufizuar **B-Jashari 2021** sh.p.k. duke percaktuar te drejta dhe detyrime ne kete status si me poshte:

KAPITULLI I

FORMA ,EMERTIMI OBJEKTI SELIA ,KOHEZGJATJA

Neni 1

Shoqëria **B-Jashari 2021** sh.p.k. (në vijim Shoqëria) krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti.

Shoqëria vepron sipas ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 Per Tregtarët dhe Shoqerite Tregtare, ligjit Nr.7850 date 29.07.1994 "Per Kodin Civil te Republikes se Shqiperise" si dhe gjithe legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

Statuti eshte në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2

EMËRTIMI

Emërtimi i Shoqërisë është **B-Jashari 2021** sh.p.k.

Shoqëria ka vulen dhe logon e saj identifikuese, ne formen dhe me ekstremitetet e caktuar nga asamblea e ortakve i shoqerise.

Neni 3

OBJEKTI I SHOQËRISË

Objekt i veprimtarise se shoqerise **B-Jashari 2021** sh.p.k. eshte ne perputhje me legjislacionin tregetar aktual Shqiptar dhe do te jete:

- Bar kafe
- Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose shtohet me vendim të Asmablesë së Përgjithshme të Ortakeve.
- Shoqëria mund të ushtrojë veprimtari të tjera plotësuese që janë të dobishme ose të nevojshme për realizimin e objektit të saj, në përputhje me ligjin shqiptar.
- Shoqëria do të bashkëpunojë me persona të tjerë fizikë ose juridikë që ushtrojnë të njëjtën veprimtari në Shqipëri ose jashtë saj. Si dhe cdo aktivite qe e lejon legjislacioni Shqiptare.

Neni 4

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISË

Kohezgjatja e Shoqerise **B-Jashari 2021** sh.p.k. eshte e pakufizuar dhe fillon ne momentin e Rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit sipas ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 nenet 26, 28, 32 dhe 35 te tij, pershtatur me Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqerite Tregtare".

Shoqëria me pergjegjiesi te kufizuar **B-Jashari 2021** sh.p.k. prishet:

Me vendim te asamblese se pergjithshme.

Me hapjen e procedurave te falimentimit.

Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Me vendim te gjykates.

Per arsye te tjera te parashikuara ne status.

Neni 5

SELIA

Selia e Shoqërisë është në adresen: *Bashkia Lezhe, Njesia Administrative Shengjin, fshati Ishull-Shengjin, Lagjia Fran Ivanaj, Rruga Kune, Ambjent ne Zonen Kadastrale 1987, Pasuria nr.28/63.*

Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Pergjithshme.

Asambleja e Pergjithshme mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si edhe jashtë saj.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E PJESËVE TË KAPITALIT

Neni 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë **B-Jashari 2021** sh.p.k. është 100.000(njeqind mije lekë).

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100.000,(njeqind mije lekë),dhe perbehet nga 1 kuota

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1.Ortaku themelues Bashkim Jashari eshte mbajtes i 100% te kuotave te kapitalit themelore qe perbehen nga 1 kuota .

Neni 7

KËRKESA PËR TË PAGUAR KUOTAT DHE TËRHEQJA E KUOTAVE TË PAPAGUARA

Administratorët mund t'u kërkojnë ortakëve të shoqërisë nese ka pagesën e kontributeve të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak (pas marrjes së njoftimit prej 14 Ditësh të Plota në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëposhtëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.

Zotëruesit e përbashkët të një kuote nese ka do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguaje një interes mbi shumën e papaguar me një kamatëvonesë prej 4% në vit duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën.

Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, Administratorët mund të njoftojnë paraprakisht të paktën katërmëdhjetë Ditë të Plota personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer së bashku me shumën e mundshme shtesë të kamatëvonesës. Njoftimi do të përmbajë vendin ku duhet të kryhet pagesa dhe deklarin se në rast moszbatimi të tij, kuotat të cilave u referohet njoftimi do të anulohen.

anullohet me vendim të Administratorëve dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose shumat e tjera pagueshme në lidhje me kuotat e anuluar dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.

Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund të shitet, rishpërndahet ortakëve ose të kalohet sipas afateve dhe mënyrave që Administratorët konsiderojnë të përshtatshme.

Personi, kuota e te cilit është anuluar, humbet cilësinë e ortakut në lidhje me këtë kuotë por do të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqërisë në datën e anulimit të kuotës së bashku me kamatëvonesën e llogaritur për këto kontribute përpara anulimit të kuotës.

Neni 8

LLOJET E KUOTAVE, TË DREJTAVE DHE KUFIZIMEVE

Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave së ortakëve, në përputhje me parashikimet e Nenit 87 të Ligjit 9901.

Neni 9

CERTIFIKATAT E KUOTAVE

Secili ortak nese ka,ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i certifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave, në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit. Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në certifikatën e kuotës. Certifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

Neni 10

MËNYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar janë lirishte të transferueshme të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë; b) shitblerjes; c) trashëgimisë; ç) dhurimit; d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

Neni 11:

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR

1.Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë.Kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.

2.Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

Neni 12:

BLERJA E KUOTAVE TË VETA

Shoqëria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do t'u shpërndahen ortakëve apo emetimi i kuotave të reja vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të Ligjit dhe Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese

të parashikuar nga ky nen. Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligjit, paditë mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritet tregtare".

KREU III ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 13:

THIRRJA E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

1. Administratorët thërrasin Asamblenë e Përgjithshme dhe, me kërkesën e ortakëve sipas Neni 84 të Ligjit, do të procedojnë me thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme.
2. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (*email*) drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblese. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe numri PIN për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin elektronik në mbledhje.
3. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 14

MBLEDHJET E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

1. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 86 i Ligjit. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (c *onference call*), audio ose audio-video, në përputhje me nenin 88 të Ligjit. Ortakët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
2. Administratorët caktojnë Kryetarin e mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e saj.
3. Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
4. Administratori, pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.
5. Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmbëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.
6. Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga: Kryetari; ose 2. një ortak ose ortakët që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit themeltar të

shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë ortakut.

7. Me përjashtim të kundërshtimit të një ortakut, deklarimi i Kryetarit se vendimi është marre në mënyrë unanime, ose me një shumicë të caktuar, nuk është miratuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.

Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

Neni 15:

VOTAT E ORTAKËVE

1. Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.

2. Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do të komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

Neni 16

KUORUMI PER MARJEN E VENDIMEVE

Ne rastin e marjes se vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme asambleja e pergjithshme mund të marre vendime të vlefshme vetëm nëse marin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë me shumë se 30% të kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", neni 87, ajo mund të marre vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë me shumë se gjysma e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" neni 88 pika 3.

Nëse asambleja e pergjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përcaktuar në nenin 17.1 të këtij statuti, nëse shoqëria do të ketë ortakë, asambleja mbledhet perseri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 17

MARRJA E VENDIMEVE NGA ASAMBLEJA E PERGJITHESHME

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë me të lartë, asambleja e pergjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës nëse ka, sic përcaktohet në nenin 86, pika 1 e ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar, shpendarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose në statut për çështjet e tjera të parashikuara në nenin 81 të ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", asambleja e pergjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmeria e vendimeve që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Neni 18
E DREJTA E VOTES

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne statut, cdo kuote jep te drejten e nje vote.

Ortaket nese do te kete, qe nuk jane te pranishem ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme kane te drejte te marin pjese me mjete te ndryshme komunikimi perfshire mjetet elektronike, me kusht qe te garantohet identifikimi i ortakeve.

Mjetet elektronike perfshijne, por pa u kufizuar ne to:

Transmetimin e mbledhjes se asamblese se pergjithshme ne kohe reale.

Komunikimin e ndersjellte ne kohe reale, i cili u mundeson ortakeve te shprehen permbledhjen e asamblese se pergjithshme nga nje vendndodhje tjeter .

Mekanizma, qe mundesojne procesin e votimit perpara apo gjate mbledhjes se mbledhjes se asamblese se pergjithshme, pa qene nevoja te caktohet nje perfaqesues i autorizuar, per te marre pjese fizikisht ne mbledhje.

Ortaku i vetem ka te drejten qe i njihet nga ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" apo statuti i shoqerise, per te marre unanimisht cdo vendim, me kusht qe kjo marveshje te behet me shkrim.

Neni 19
PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per :

Vleresimin e veprimtarise se tij .

Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.

Ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria.

Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku te cilin perfaqeson.

Neni 20
PROCESVERBALI I MBLEDHJES SE ASAMBLESE

Vendimet e asamblese se pergjithshme duhet te rregjistrohen ne proces verbal. Administratoret pergjigjen per ruajtjen e kopjeve te proces verbaleve te mbledhjeve te asamblese se pergjithshme.

Procesverbali duhet te permbaje daten e vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrin e kryetarit e te mbajtesit te procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkelidhet edhe lista e pjesmaresve, si edhe akti i thirrjes se asamblese se pergjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nenshkruset nga kryetari dhe nga mbajtesi i procesverbalit .

Neni 21
HETIMET E POSAÇME

Personi ose personat qe plotesojne kushtet per te kerkuar emerimin apo zevendesimin e nje eksperti te fushes sipas nenit 91 te Ligjit paraqesin nje kerkesa te tille nepermjet depozitimit te nje deklarate noteriale ne seline e shoqerise e cila verteton se personi ose personat plotesojne kushtet per kryerjen e ketij veprimi.

ADMINISTRATORËT

Neni 22
EMËRIMI I ADMINISTRATORËVE DHE I DREJTUESIT TEKNIK

1.Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratorë te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte ripertitjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2.Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie

të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3.Administratort I Shoqërisë B-Jashari 2021 sh.p.k. emrohet Z.Bashkim Jashari,atesia Musa,amesia Nexhmije i datelindjes 03.03.1968 lindur dhe banuese ne Vushtrri,Kosove me dokument identifikim leternjoftim kosovare me nr.10017877256,me nje afat 5 vjecar me te drejte riperseritje.

Neni 23

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

Administratort kanë të drejtë e detyrohen të:

Te kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë,duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme.

Te përfaqësojnë shoqërinë tregtare.

Te kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë.

Te përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim

Te krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.

Te kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Te raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e Politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

Te kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut

Administratort jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim. -shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. -shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e adminis marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Kreu V

DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR

Neni 24

DIVIDENDËT

Pas plotësimit të parashikimeve të Nenit 77 të Ligjit 9901, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhet në përputhje me shumat e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhet në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë.

Neni 25

KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit 9901, mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

KREU VI

PRISHJA DHE NJOFTIMET

Neni 26

PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- 1.Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj.
- 2.Me vendim të asamblesë së përgjithshme.
- 3.Me hapjen e procedurave të falimentimit.
- 4.Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.
- 5.Me vendim të gjykatës
- 6.Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse jane Nenet 191 deri në 203 të Ligjit 9901. Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me nenet 204 dhe 205 të Ligjit 9901.

Neni 27

RREGJISTRIMI I SHPERBERJES

Administratoret rregjistrojne prishjen e shoqerise prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit ne perputhje me ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007 “ Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit”, neni 43.

Nese prishja e shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata ne perputhje me ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit”, neni 45, ia njofton vendimin Qendres Kombetare te Rregjistrimit per rregjistrim.

Neni 28

LARGIMI I ORTAKUT PER SHKAQE TE ARSYESHME

Ortaku mund te largohet nga shoqeria nese ortaket e tjere nese ka, ose shoqeria ka kryer veprime ne dem te tij, nese eshte penguar te ushtroje te drejtat e tij, nese shoqeria i ka ngarkuar detyrime te pa arsyeshme apo per shkaqe te tjera, qe e bejne te pamundur vazhdimin e ortakerise .

Ortaku nese shoqeria eshte me disa ortake, qe kerkon largimin, duhet te njoftoje shoqerine me shkrim, si dhe te parashtrroje shkaqet e largimit. Administratoret duhet te therrasin mbledhjen e asamblese se pergjitheshme menjehere pasi te kene marre dijeni per njoftimin e largimit, sipas parashikimeve te nenit 26.2 te statutit, per te vendosur nese ortakut do ti likujdohet kuota, si pasoje e largimit per shkaqe te arsyeshme.

Ortaku qe kerkon largimin nga shoqeria, detyrohet ta demshperbleje shoqerine per demet e shkaktuara, nese rezulton se largimi eshte kryer ne baze te shkaqeve te paarsyeshme.

Neni 29

PERJASHTIMI I ORTAKUT

Asambleja e pergjitheshme ne baze te nje vendimi te zakonshem mund ti kerkoje gjykates perjashtimin e ortakut nese shoqeria eshte me disa ortake, nese ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve te statutit ose nese ekzistojne shkaqe te tjera te arsyeshme per kete perjashtim.

Do te konsiderohen shkaqe te arsyeshme per perjashtimin e ortakut por pa u kufizuar ne to, rastet kur ortakut:

Me dashje apo me pakujdesi te rende i shkakton deme shoqerise ose ortakeve te tjere.

Me dashje apo me pakujdesi te rende shkel statutin ose detyrimet e percaktuara me ligj .

Perfshihet ne veprime, te cilat e bejne te pamundur vazhdimin e mardhenieve midis shoqerise tregtare dhe ortakut, ose

Me veprimet e tij demton ose pengon ndjeshem veprimtarine tregtare te shoqerise

Neni 30

EKSPERTI KONTABËL I AUTORIZUAR

Eksperti Kontabël i Autorizuar emerohet nga Asambleja e Pergjithshme ose me Vendim Gjykate per kontrollin e bilanceve, librave kontabël të Shoqërisë etj.

Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet ne çdo moment sipas mënyrave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 31

VITI FINANCIAR DHE BILANCI VJETOR

Ushtrimi financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor te cdo viti.

Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendren Kombetare te Rregjistrimit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit. Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe nese jane te nevojshme të ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja e Pergjithshme.

Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 32

FITIMET

Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% (pesë për qind) që caktohen për rezervën ligjore deri në 10% (dhjetë për qind) e kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumatat që Asambleja e Pergjithshme vendos t'i vërë ne dispozicion te shoqerise, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara respektivisht.

Asambleja e Pergjithshme mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

Neni 33

NJOFTIMET

1. Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik

në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

2. Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortaku. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

3 Ky Statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohet nga Administratorët në faqen e internetit të shoqërisë, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 të këtij Statuti (nëse zbatohet)

Neni 34

LIKUIDIMI

Në rast prishje, Shoqëria do të likuidohet. Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Pergjitheshme emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja Pergjitheshme do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi vlefshmerinë e punës së kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit. Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredivë, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakut apo ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 35

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Per ceshjet qe nuk parashikohen ne kete statut zbatohen dispozitat e ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Ky statut eshte hartuar ne 4 (kater) kopje ne ne dy gjuhe shqipe dhe italiane pasi iu lexua ortakët e shoqerise, dhe u pranua vullnetarisht nenshkruhet prej tyre.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE BASHKIM JASHARI PERFAQESUAR ME PROKURE

Shqipe Dedo

